

AKT NORMATIV
Nr.3, datë 7.9.2011

PËR HEQJEN E MJETEVE MOTORRIKE, TË RIMORKIOVE, SI DHE TË PJESËVE TË TYRE TË KËMBIMIT, TË DALA JASHTË PËRDORIMIT, QË NDODHEN PRANË RRUGËVE KOMBËTARE

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Neni 1

Marrjen e masave të menjëhershme për përballimin e situatës emergjente, të krijuar nga gjendja e rënduar dhe problematike e vendgrumbullimeve të mjeteve motorike, të dala jashtë përdorimit, pranë rrugëve kombëtare, të cilat kanë ndikuar në ndotjen e mjedisit dhe përkeqësimin e sigurisë rrugore në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 2

Ndalimin e krijimit të vendgrumbullimeve dhe grumbullimin e mjeteve motorike, rimorkiove, si dhe të pjesëve të tyre të këmbimit, të dala jashtë përdorimit, në një distancë jo më pak se 1 km nga akset e rrugëve kombëtare, të përcaktuara si të tilla me vendim të Këshillit të Ministrave, si dhe në vende të tjera të paautorizuara nga organet apo institucionet përkatëse, të ngarkuara me akte ligjore dhe nënligjore për këtë qëllim.

Neni 3

Pronarët ose poseduesit e vendgrumbullimeve ekzistuese të mjeteve motorike, rimorkiove dhe pjesëve të tyre të këmbimit, të dala jashtë përdorimit, që nuk plotësojnë kërkesat e nenit 2 të këtij akti normativ, brenda 1 (një) muaji nga hyrja në fuqi e tij, duhet t'i largojnë, me shpenzimet e veta, nga vendndodhja e tyre aktuale këto mjete. Ato mund t'i rivendosin në vende të tjera, të lejuara dhe të autorizuara për këtë qëllim, duke zbatuar edhe kërkesat e tjera ligjore për ushtrimin e veprimtarisë dhe mbrojtjen e mjedisit.

Neni 4

Inspektorati i Mjedisit, kur konstaton shkeljen e kërkesave dhe afateve të përcaktuara në nenet 2 e 3 të këtij akti normativ, vendos konfiskimin e mjeteve motorike, të rimorkiove, si dhe pjesëve të tyre të këmbimit, të dala jashtë përdorimit, që ndodhen në këto vendgrumbullime.

Kundër vendimit të konfiskimit, pronarët ose poseduesit e këtyre mjeteve, brenda 5 (pesë) ditëve nga data e vendimit, mund të kryejnë ankim pranë Agjencisë Rajonale të Mjedisit, e cila duhet të shprehet brenda 5 (pesë) ditëve.

Neni 5

Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për kryerjen e transportit të mjeteve motorike, rimorkiove, si dhe pjesëve të tyre të këmbimit të konfiskuara dhe të procedurave të shitjes së tyre.

Efektet financiare të transportit dhe shitjes do të përballohet nga të ardhurat e realizuara nga shitja e këtyre mjeteve.

Neni 6

Procedurat për evidentimin, konfiskimin, transportin dhe shitjen e këtyre mjeteve përcaktohen me udhëzim të përbashkët të Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Ministrit të Financave, Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit dhe Ministrit të Mbrojtjes.

Neni 7

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha